

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Ganimete Hasani Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditësit Rr.R., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Komisioni i ankesave, me bazë juridike, anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditësit, me datën 9 qershor 2016, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr.R.nga P..
- II. ANULOHET** Vendimi i të paditurës Komuna e Prishtinës 01.nr.361-1327, i datës 06.04.2009 dhe çështja i kthehet të paditurës në rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

Paditësi N.A.me padinë ushtruar me dt. 19.06.2009, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës Komuna e Prishtinës 01.nr.361-1327, i datës 06.04.2009, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e ushtruar kundër Njoftimi të Komisionit për Ndarjen e Banesave për Shfrytëzim me Qira 01.nr.111-25798 e datës 05.01.2009. Ka pretenduar se vendimi i goditur me padi nuk është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen faktike, pasi që i njëjti nuk e ka zgjidhur çështjen e banimit, ndërsa shtëpia në pronën e tij është e shkatërruar dhe e pabanueshme. Pohon se jeton në shtëpi të vllaut pikërisht për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe në këtë gjendje konsideron se i plotëson kriteret për dhënien e banesës në shfrytëzim. Kërkon që padia t'i aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i të paditurës të anulohet.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 16.11.2012, ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar dhe ka pohuar se komisioni për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira, ka shqyrtuar ankesën e paditësit me ç'rast ka konstatuar se paditësi nuk ka pasur pikë të mjaftueshme për të qenë përfitues me rastin e ndarjes së këtyre banesave. I ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, ka prezentuar paditësi, ndërsa ka munguar e paditura, e ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur pa praninë e të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 9 qershor 2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i Gjykatës Supreme A.nr 494/2009 i datës 27.08.2009, vërtetimi i të paditurës nr. 01-981 i datës 21.11.2000, përgjigja ne kërkesë nga ZK 659/05 e datës 28.10.2005, shpallja e të paditurës nr. 111-25798 e datës 20.12.2006, kërkesat e paditësit nr.111-25798/154 të datës 19.01.2007, 03.01.2008, 05.10.2009, 30.06.2011, pyetësi i paditësit 19.01.2007, kërkesa e paditësit pa numër dhe datë,

kontrata e punës e paditësit e datës 20.09.2006, çertifikata e lindjes e B.R. e datës 24.06.2006, vërtetimet e të paditurës nr. 204/2000 të datës 04.09.200 dhe nr.32 e datës 18.04.2003, fatura e obligimit tatimor i të paditurës në emër të I.R. e datës 12.08.2003, shkresa nga MAPL nr. 659/05 e datës 18.01.2006, çertifikata e paditësit nr. 575/73 e datës 30.09.1991, fatura e energjisë eklektike në emër të I. R. e datës 09.09.2006, raportet mjekësore në emër të paditësit të datës 23.11.2005, 20.09.2004, 05.03.2005, 03.09.2005, vendimi i të paditurës nr. 111-95798 i datës 05.01.2009, ankesat e paditësit të datës 09.01.2009, 28.02.2009, 29.05.2012, 08.03.2013, vendimi kontestues nr. 361-1327 i datës 06.04.2009, vërtetimi i të paditurës nr. 514 i datës 26.06.2009, shkresa e Avokatit të Popullit nr.093/2011 e datës 30.03.2011, aktgjykimi C.nr 2030/09 i datës 14.02.2013, vendimi C.nr. 61-01/13 i datës 06.03.2013, vendimi ZRRE nr.1032/12 i datës 09.03.2012, vërtetimet nga Shkolla Fillore “A.Z.ÇAJUPI” nr.16 të datës 10.09.2008, nr.118/2012, 287/08 të datës 22.09.2008, aktvendimi i Gjykatës së Apelit AC.nr. 1382/13 i datës 05.10.2013, shkresa nga ZPD nr.ZPD/15 /ZP/144 e datës 05.03.2015, përgjigja në kërkesë nga MAPL nr.360-789 e datës 16.06.2014, njoftimi i të paditurës i datës 16.10.2012, kontrata e punës e paditësit nr.112/18 e datës 01.09.2009, Aktvendimi C.nr.2434/2015 i datës 16.11.2015 si dhe fatura e tatimit në pronë në emër të paditësit e datës 02.06.2016

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetim nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: *Komisioni për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira, ka shqyrtuar kërkesën e shërbyesit civil të Komunës së Prishtinës dhe pas shqyrtimit të saj, ka bërë vlerësim të drejtë të pikëve ashtu siç është përshkruar me dispozitat e Rregullores për ndarjen e banesave në shfrytëzim dhe se nuk keni pikë të mjaftueshme që të jeni përfitues”.*

Konstatimet e komisionit të cekura në arsyetimin e vendimit të atakuar janë në kundërshtim me provat e prezantuara nga paditësi. Nga kontrata e punës e paditësit, rezulton se paditësi është punonjës pranë të

paditurës në D.A. Nga vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, del se paditësi nuk jeton në shtëpinë e tij pasi që e njëjta është e shkatërruar nga lufta dhe si rrjedhojë nuk ka pas shpenzim të energjisë elektrike. Nga fatura e tatimit në pronë e datës 02.06.2016, vërtetohet se shtëpia në emër të paditësit është e pabanueshme dhe si e tillë është braktisur. Paditësi gjithashtu ka gjendjen e rëndë shëndetësore, fakt ky i vërtetuar në bazë të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës. Të gjitha provat e lartcekura, e bëjnë vendimin e të paditurës të pabazuar, në kundërshtim me gjendjen faktike të provuar nga paditësi dhe në kundërshtim me nenin 10 lidhur me nenin 12 të Rregullores për Dhënien e Banesave në Shfrytëzim me Qira 01 nr.215-361, të datës 04.05.2006 e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 nr. 361-1327 të datës 11.09.2008, aprovuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i padituri, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë apo në bazë të cilave fakte kanë konstatuar se paditësi nuk i plotëson kushtet për ndarjen e banesës në shfrytëzim.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Prandaj gjykata konstaton se në rastin konkret organi i paditur ka shkelur ligjin në dëm të paditësit sepse vendimi i atakuar, është marrë pa u shqyrtuar drejtë gjendja faktike respektivisht me rastin e vendosjes nuk janë marrë për bazë faktet vendimtare.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur , duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.122/16 me datë 9 qershor 2016**

G j y q t a r j a  
Arjeta Sadiku

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.